



ORNELA DOCI

Drejtoresh e Marrëdhënieve me Publikun në Spitalin Amerikan - Tiranë

“Përveç kurimit me metodat më të reja dhe gjithë mundësitë që mjekësia moderne ofron, në Spitalin Amerikan, i kemi kushtuar një rëndësi të veçantë mjekësisë parandaluese. Vendet e zhvilluara duke u bazuar në diagnostikimin dhe kurimin e hershëm kanë arritur të ulin ndjeshëm numrin e pacientëve që vuajnë nga sëmundje të rëndësishme si diabeti, sëmundje të arterieve koronare, kancer të ndryshëm etj.

#### Paketat check - up të ofruara në SA

- Check up për fëmijë
- Check up për të rinj
- Check up standart
- Check up për meshkuj mbi 40 vjeç
- Check up për femra mbi 40 vjeç
- Check up i shtatëzanisë
- Check up për diabetikë
- Check up kardiak
- Check up për pacientë të diagnostikuar me kancer
- Check up VIP
- Check up EXE

#### Ekzaminimet e një kontrolli kardiak

- Gjak komplet
- Urea
- Creatinina
- Cholesterol
- Triglycerides
- LDL
- HDL
- VLDL
- Lipoprotein (a)
- Urinë komplet
- Grafi pulmoni
- ECG
- Echo
- Treadmill Test (Stress ECG)
- Holter ritmi
- Holter tensioni
- CT angio koronare/CT Ca score
- Konsultë me kardiologun

# E shtuna Vital

nga American Hospital



## CHECK - UP

### KONTROLLI QË SHPETON JETË

#### Çfarë janë programet e kontrollit të përgjithshëm ose paketat check-up?

Përveç kurimit me metodat më të reja dhe gjithë mundësitë që mjekësia moderne ofron, në Spitalin Amerikan, i kemi kushtuar një rëndësi të veçantë mjekësisë parandaluese. Vendet e zhvilluara duke u bazuar në diagnostikimin dhe kurimin e hershëm kanë arritur të ulin ndjeshëm numrin e pacientëve që vuajnë nga sëmundje të rëndësishme si diabeti, sëmundje të arterieve koronare, kancer të ndryshëm etj. Nga rreth 18000 pacientë ambulatorë dhe të shtruar që kemi patur deri tani, me keqardhje kemi konstatuar se pacientët paraqiten tek mjeku vetëm atëherë kur sëmundja e ka treguar veten me gjithë simptomat e saj. Sigurisht në këtë fazë kurimi bëhet akoma më i vështirë dhe jo rrallë edhe i pamundur. Mund të përmendim këtu kancerin e gjirit që nëse diagnostikohet në fazat e tij fillestare kurohet me sukses në shumicën e rasteve, por nëse lihet pas dore arin në fazat të avancuara dhe pacientet i kushton jetën.

Pikërisht për këtë arsye Spitali Amerikan ka hartuar programet check up.

**Check-up ose i shpjeguar ndryshe në shqip si kontroll mjekësor periodik, është një paketë ekzaminimesh laboratorike dhe imazherike që kryhen për identifikimin dhe parandalimin në një stad ende jo të avancuar të sëmundjeve të ndryshme.**

#### Çfarë përbajnë paketat check-up, për kë janë hartuar dhe në sa kohë duhen përsëritur?

Pothuaj çdo çrregullim shëndetësor që do të gjenerojë më vonë në një sëmundje, shfaqet në rezultatet e check-up-it si prishje e ekuilibrit biokimikë. Për të kapur herët këto çrregullime të organizmit duhet që të gjithë të kontrollohemi të paktën një herë në vit. Në personat me moshë mbi mesataren dhe ata me histori familjare për një sëmundje të caktuar, ky grup ekzaminimesh duhet kryer çdo gjashtë muaj. Në Spitalin Amerikan, programet e kontrollit periodik janë të ndryshme për fëmijë, të rinj, gra mbi 40 vjeç, burra mbi 40 vjeç, për gra shtatzëna, për pacientë diabetikë, pacientë kardiakë etj. Në secilin prej këtyre programeve ka ekzaminime që janë shumë të rëndësishme dhe domethënëse për grupe të caktuara pacientësh.

Nga këto mund të përmendim pap test, echon e gjirit dhe markerin e tumorëve të vezoreve CA125 për gratë mbi 30 vjeç, densitometrinë e kockave dhe mamografinë për gratë mbi 40 vjeç, analizën e urinës komplet për diagnostikimin e patologjive të sistemit renal, markerat tumorale Free PSA/PSA tek meshkujt mbi 40 vjeç, lipidogramën në moshë mbi mesataren dhe në pacientë kardiakë, radiografinë ose skanerin e mushkërive për grupin e duhanpirësve etj. Përveç këtyre një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe depistimit për Hepatitin B duke patur parasysh përqindjen e lartë të mbartësve të këtij virusi dhe mënyrën e transmetimit të tij nëpërmjet rrugëve të gjakut dhe seksuale si edhe mundësinë që egziston sot për t'u vaksinuar dhe mbrojtur nga kjo sëmundje që jo

rrallë ka pasojë fatale.

Check-up ka një rëndësi të veçantë për personat me një histori familjare për një sëmundje të caktuar, pra nëse mbartin faktorë rreziku për këtë sëmundje.

**Ankesat e pacientit, historiku personal dhe familjar, mënyra e jetesës, ushqyerjes dhe aktivitetit fizik janë shumë domethënëse në përcaktimin e një diagnoze të saktë.** Vizita e mjekut, egzaminimet imazherike si ultrasonografia, tomografia apo rezonanca magnetike, bashkë me analizat e detajuara të gjakut e urinës plotësojnë një paketë të plotë check-up-i.

#### A është e mundur që me anë të këtyre egzaminimeve të diagnostikohen hipertensioni, sëmundje të zëmrës, diabeti etj.?

Sot, në sajë të avancimit të mundësive që mjekësia ofron, me diagnostikimin e hershëm nëpërmjet check-up-ëve të rregullta arrihet të parandalohen dhe kurohen një numër i madh sëmundjesh si diabeti, sëmundje të arterieve koronare, dislipidemia që është një nga shkaqet kryesore të sëmundjeve të arterieve, sëmundje pulmonare, sëmundje të mëlçisë të shkaktuara nga hepatiti ose alkoholi, tipe të ndryshme të anemisë, kancer të gjirit, uterusit, prostatit, aparatit tretës ose pankreasit, osteoporozë etj. **Sigurisht që do të ishte shumë më mirë nëse, pa pritur shqetësimet, të gjithë t'i nënshtroheshin kontrolleve periodike të përgjithshme që do të ndihmonte në paraprirjen e problemeve.**

#### Çfarë është një check up EXE?

Është vetëm një prej numrit të madh të paketave të personifikuara sipas specifikave të personave. Sikundër ekzistojnë paketa check up të ndara sipas seksit apo grupmoshave, janë hartuar edhe paketa kontrolli për personat me intensitet të lartë pune, stresi e aktiviteti. Nga pacientët tanë kemi vënë re se kjo kategori, falë edhe intensitetit të lartë të punës, shpesh e lë veten pas dore. **Ata që kanë kohë të kufizuar për aktivitete relaksuese apo fizike, që kanë një rregjim jo të rregullt ushqyerjeje**



**dhe që përballen pothuaj çdo ditë me stresin e punës e kanë shumë të domosdoshëm një kontroll periodik e të gjithanshëm të paktën një herë në 6 muaj.** Me një gamë disi më të gjerë ekzaminimesh të detajuara janë hartuar paketat EXE që janë më të përshtatshme për këtë kategori personash dhe që përfshijnë edhe rezonancë magnetike, skaner, teste virusale etj.

#### Çfarë këshillash paraprake duhet të kenë parasysh ata që paraqiten për check-up?

Duhet patur parasysh se para se të paraqiteni për një check-up duhet paraprakisht të merret një takim me mjeken patologje dhe ditën e kontrollit duhet të paraqiteni në klinikë në mëngjes pa konsumuar ende asnjë ushqim dhe të sillni me vete rezultate të kontrolleve të mëparshme nëse dispononi. Gratë shtatzëna duhet patjetër ta venë në dijeni mjekun për shtatëzaninë e tyre para se të fillojnë procedurën e check-up. Personi që vjen për check-up duhet të vishet lehtë, me rroba të rehatshme dhe që ti lejojnë lëvizshmëri në rast prove ushtrimore, EKG, echo etj dhe nëse është duke përdorur medikamente për trajtim kardiak apo hipertensiv duhet që mjeku që do të ndjekë check-up-in të vihet në dijeni që në marrjen e takimit.

Rekomandohet që check-up të mos bëhet në periudhë kur organizmi pëson ndryshime si psh gjatë ciklit të menstruacioneve, në gjëndje gripale etj.

#### Egziston mendimi se nëse paraqitesh tek mjeku për kontroll domosdoshmërisht do të rezultosh me një problem shëndetësor. Si është këndvështrimi i Spitalit Amerikan në këtë aspekt?

Ka ardhur koha që shqiptarët që fillojnë të kujdesen për shëndetin e tyre, të parandalojnë pa u dashur të kurojnë. Është e vërtetë që egziston një skepticizëm i tillë por numri në rritje i personave që i kushtojnë rëndësi kontrollit periodik na ka bërë të mendojmë se ky mentalitet ka filluar të ndryshojë. **Qëllimi ynë është të jemi themelues të një mentaliteti ndryshe dhe besoj mijëra pacientë që kanë marrë shërbim nga Spitali Amerikan në këto dy vite e vërtetojnë këtë.** I kemi kushtuar vëmendje informacionit të gjithësecilit për grupin e gjakut dhe kemi pajisur rreth 4000 pacientë me kartën personale të grupit të gjakut. Një rëndësi të veçantë i kemi dhënë depistimit për Hepatitin B duke theksuar rëndësinë e vaksimit për këtë virus. Kemi organizuar fushata depistimi falas për grupe të ndryshme si pensionistët, duhanpirësit mbi 50 vjeç, fëmijët në nevojë etj dhe do të vazhdojmë të kemi të tilla iniciativa për të rritur sensibilitetin ndaj parandalimit të sëmundjeve. Edhe kjo ndërmarrje e jona për paketat e check-up ka një aspekt të fortë social që do të ndihmojë në ndërgjegjësimin e shqiptarëve për rreziqet që i presin nëse nuk diagnostikojnë dhe parandalojnë në kohë sëmundjet që shtohen dita ditës nga stresi, ndotja e ambientit, kequshqyerja, abuzimi me alkoolin e duhanin, dukuri këto shumë problematike për shoqërinë tonë.